KOMUNIKATË PËR MEDIA

Konferencë me Media – Java e II-të në terren e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

15 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sot u mbajt Konferencë me Media lidhur me ecurinë e punës në terren që nga fillimi i Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) më 5 prill 2024.

U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, tha se "Procesi i Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë vazhdon sipas planit. Këto ditë është tejkaluar plani i pritshmërisë për nurmin e intervistave brenda një dite, që do të thotë se mund të ndodhë që intervistat të jenë realizuar para datës së paraparë."

Të gjitha komunitetet janë duke marrë pjesë në Regjistrim, duke përfshirë edhe shumë banorë të Veriut të Kosovës që janë duke u regjistruar.

Gjithashtu U.d. Kryeshefi ka bërë thirrje që qytetarët e kanë të drejtën t'i shikojnë përgjigjet e tyre nëse të dhënat e deklaruara po shkruhen saktë.

Më pas, gjatë konferencës u bë edhe një prezantim nga z. Burim Limolli, udhëheqës i IT në ASK, rreth monitorimit të regjistruesve në terren dhe për numrin e intervistave të kryera gjatë këtyre ditë.
Z. Limolli prezantoi se:

- sipas rezultateve të përcjella me GPS ka mbi 110 mijë objekte.
- Janë intervistuar mbi 47 122 ekonomi familjare.
- Deri me tani janë regjistruar mbi 200 mijë individë.
- Gjithashtu ka edhe një numër të madh të të regjistruarve nga Diaspora (mbi 50 mijë) .